



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Nr. 78 prot.

Kamëz, më 26.9.2025

V E N D I M
Nr. 66. Datë 26/9 2025
M B I

**“MIRATIMIN E ÇMIMIT TË BILETAVE DHE ABONEVE TË LINJAVE TË
TRANSPORTIT URBAN NË BASHKINË KAMËZ”**

Këshilli Bashkiak Kamëz i mbledhur sot me datë 26.09.2025, pasi mori në shqyrtim Projekt-vendimin Nr.68 Datë 23.09.2025 në zbatim të nenit 53, pika 3, gërma b, të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”; nenit 43 të Rregullores së Këshillit Bashkiak nr. 33, datë 21.03.2024 “Për miratimin e rregullores për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Bashkisë Kamëz”; Ligjit nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore”, të ndryshuar; Vendimit nr. 85, datë 08.02.2017 “Për përcaktimin e rregullave për prodhimin, shpërndarjen dhe pajisjen e udhëtarëve me biletat e transportit rrugor” (i ndryshuar); Udhëzimit nr. 3743, datë 10.07.2017 “Mbi modelet dhe standartet e biletave të transportit rrugor të udhëtarëve” (i ndryshuar); Shkresës nr. 7767 prot., datë 10.09.2025, me lëndë: “Kërkesë për rritjen e çmimit të biletave të transportit me 10 (dhjetë) lekë për Linjat rrethqytetëse mbi 8km”, të ardhur nga Shoqata e Transportit Urban dhe Interurban; si dhe Shkresës nr. 77 prot., datë 17.09.2025, me lëndë: “Kërkesë për futjen në rend dite të një propozimi për miratim nga Këshilli Bashkiak”, **Këshilli Bashkiak Kamëz**;

V E N D O S I:

- I. Miratimin e rritjes së çmimit të biletave dhe aboneve për linjat e transportit urban mbi 8 km.
II. Të miratojë çmimin e biletave dhe aboneve për linjat e transportit urban mbi 8 km, si më poshtë:

- Linja “KAMËZ – TIRANË - KAMËZ”**, që përfshin (Bulevardi Nënë Tereza; - Tiranë (Rruga “Kastriotët”, Mbikalimi i Kamzës, Rruga “29 Nëntori”, Rruga “Dritan Hoxha”, Rruga Durrësit, Rruga “Dëshmorët e 4 Shkurtit”, Rruga “Myslim Shyri”, Rruga “Abdi Toptani”, Rruga “Xhorxh Bush”, Rruga “Ludovik Shllaku”, Rruga Dibrës, Rruga “Urani Pano”, Rruga “Dedë Gjo Luli”, Rruga “Mine Peza” dhe kthim).
 - Tarifa e biletës të bëhet 50 (pesëdhjetë) lekë.
 - Tarifa e abonesë të bëhet 1400 (një mijë e katërqind) lekë.
 - Tarifa e abonesë së përgjithshme të jetë 1600 (një mijë e gjashtëqind) lekë.
- Linja “PASKUQAN - BABRRU – TIRANË”**, që përfshin (Rruga Demokracia - Paskuqan; - Tiranë (Rruga “Agllai Tako”, Rruga “Njazi Meka”, Rruga “Gaco Tashko”, Rruga “Niko Avrami”, Rruga Dibrës, Rruga Barikadave, Rruga “Ludovik Shllaku”, Sheshi Operas dhe kthim).
 - Tarifa e biletës të bëhet 50 (pesëdhjetë) lekë;
 - Tarifa e abones mujore për këtë linjë të bëhet 1400 (një mijë e katërqind) lekë.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

- Tarifa e abones mujore për këtë linjë të bëhet 1400 (një mijë e katërqind) lekë.
- Tarifa e abonesë së përgjithshme të jetë 1600 (një mijë e gjashtëqind) lekë.

III. Të përcaktojnë çmimin e biletave dhe aboneve për linjat e transportit urban nën 8 km, (i pandryshuar) si më poshtë:

1. **Linja "KAMËZ - BËRXULLË - DEGËZIMI KOZARE (COCA COLA) DHE KTHIM"**, që përfshin (Rruga Skënderbeu, Rruga "Nënë Tereza" dhe kthim) Degëzimi Coca Cola përfshin (Rruga "Skënderbeu", Rruga "Kozare", Rruga "Lunxhëri", Rruga "Lura", Rruga "Coca Cola" dhe kthim).
2. **Linja "UNAZA LINDORE KAMËZ"** - që përfshin (Rruga "Berisha", Rruga "Besëlidhja", Rruga "Erzeni", Rruga "Dajti", Rruga Banka Botërore, Rruga Arbërit dhe kthim).
3. **Linja "UNAZA PERENDIMORE KAMEZ"** - që përfshin (Rruga "Skënderbeu", Rruga "Nato", Rruga "Thethi", Rruga "Abdi Bej Toptani", Bulevardi "Nënë Tereza" dhe kthim).
4. **Linja "RRETHRROTULLIMI BATHORE - ZALL-HERR DHE KTHIM"** - që përfshin (Rruga "Demokracia" - Bathore, Rruga Zall Herr dhe kthim).
5. **Linja "KAMËZ - CERKEZË"** - që përfshin (Rruga "Berisha", Rruga "Argjinatura", Rruga Cerkezës dhe kthim).
6. **Linja "KAMËZ - TAPIZË"** - që përfshin (Bulevardi "Nënë Tereza", Tapizë, Dritas dhe kthim).
7. **Linja "UNAZA USHQYESE PASKUQAN"** - që përfshin (Rruga Demokracia - Paskuqan, Rruga Korabi, Rruga Besim Çera, Rruga "Lidhja Prizrenit", Rruga "Azem Hajdari", Rruga "Demokracia" - Paskuqan, Rruga "Azem Galica", Kafja Rremës dhe kthim).
8. **Linja "UNAZA USHQYESE BABRRU"** - që përfshin (Rruga "Konferenca e Mukjes", Rruga "Halit Haxhija" dhe kthim).

Për të gjitha linjat e sipërcituara:

- Tarifa e biletës do të jetë 40 (dyzetë) lekë.
- Tarifa e abones mujore do të jetë 1000 (një mijë) lekë.
- Tarifa e abonesë së përgjithshme të jetë 1600 (një mijë e gjashtëqind) lekë.

IV. Shfuqizimin e Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 151, datë 05.12.2016 "Mbi studimin për riorganizimin e transportit publik urban, miratimin e linjave të rregullta të transportit të udhëtarëve qytetës dhe rrethqytetas dhe e tarifës së biletës dhe aboneve për çdo linjë në Bashkinë Kamëz"; Vendimit nr. 53, datë 24.04.2017 "Për miratimin e ndryshimit të tarifës së



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ**

biletës dhe aboneve për çdo linjë të rregullt të transportit të udhëtarëve qytetas dhe rrethqytetëse që operojnë në Bashkinë Kamëz si dhe miratimin e ngjyrës së biletës për çdo linjë”.

V. Ngarkohet për zbatim Drejtoria e Licensave dhe Transportit.

VL Ky vendim hyn në fuqi pas **konfirmimit ligjor nga Prefekti i Qarkut Tiranë.**

**KRYETAR KËSHILLI
HYSEN KOLDASHI**

